



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 804 Prot.

Tiranë, më datë 08.06.2021

VENDIM  
Nr. 275, datë 08.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.06.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të *Gërmimit Arkeologjik për strukturat arkeologjike të zbuluara gjatë projektit të prishjes së shkollës “Llambi Goxhomani”, Lagjja “Mangalem”, Berat*, në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban për Bashkinë Berat, realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani, i cili do të realizojë gërmimin arkeologjik për *strukturat arkeologjike të zbuluara gjatë projektit të prishjes së shkollës “Llambi Goxhomani”, Lagjja “Mangalem”, Berat* në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban për Bashkinë Berat, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Rezultati i Gërmimit arkeologjik, të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

